

## **EKSTRAKT NGA KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË JETËS (ME MBIJETESË)**

Në zbatim të Ligjit Nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe Statutit e shoqërisë SiCRED sh.a., paraqesim si vijon ekstrakt të kushteve të Kontratës “Sigurimi i Jetës (me mbijetesë):

### **1.1 PËRCAKTIME TË PËRGJITHSHME**

Në këto kushte të përgjithshme termat e përdorur kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. **“Sigurues”**, nënkupton Shoqërinë e Sigurimit SiCRED sh.a., me të cilën lidhet një kontratë sigurimi dhe e cila do t’i paguajë Përfituesit përfitimet e përcaktuara në kontratën e sigurimit.
2. **“Kërkesë”**, nënkupton Paraqitje me shkrim e interesit të kërkuarit në adresë të siguruesit për lidhjen e një kontrate sigurimi.
3. **“Kontraktues”**, nënkupton Personin fizik ose juridik që lidh Kontratën e Sigurimit me Siguruesin.
4. **“I siguruar”**, nënkupton Personin fizik jeta e të cilit sigurohet dhe me mbijetesën ose vdekjen e të cilit lidhet pagesa e shumës së Sigurimit, për të cilën është rënë dakord.
5. **“Përfitues”**, nënkupton Personin fizik që përfiton shumën e rënë dakord në kontratë.
6. **“Policë sigurimi”**, nënkupton Dokumentin që vërteton lidhjen e Kontratës së Sigurimit të Jetës.
7. **“Prim sigurimi”**, nënkupton shumën, të cilën i Siguruari / Kontraktuesi është i detyruar t’i paguajë Siguruesit në bazë të kontratës për Sigurimin e Jetës (me mbijetesë)
8. **“Periudha e Sigurimit”**, nënkupton kohëzgjatjen e kontratës së sigurimit.
9. **“Periudha e Pagesës së Primit”**, nënkupton periudhën, gjatë të cilës paguhen primet, periudhë e cila është e përcaktuar në kërkesën për sigurim. Kjo periudhë nuk mund të jetë më e gjatë se periudha e sigurimit.
10. **“Ngjarja e sigurimit”**, nënkupton ngjarjen e ardhshme, e cila është e pavarur nga vullneti i të Siguararit. Një ngjarje e tillë është vdekja e papritur e të Siguararit brenda periudhës së sigurimit apo mbijetesë e këtij të fundit deri në përfundimin e periudhës së sigurimit.
11. **“Shuma e sigurimit”**, nënkupton shumën e rënë dakord, për të cilën lind detyrimi i Siguruesit i përcaktuar me kontratën e sigurimit/policën e sigurimit.
12. **“Shuma e kapitalizuar”**, nënkupton shumën që Siguruesi do t’i japë të siguararit, në përfundim të periudhës së sigurimit, në rast se i siguruari e ndërpret kontratën e sigurimit dhe nuk e tërheq vlerën e primeve të paguara.
13. **“Vlera e primit të kthyer”**, nënkupton shumën që Siguruesi do t’i kthejë Kontraktuesit /të Siguararit në rast të përfundimit të parakohshëm të kontratës së Sigurimit.
14. **“Rezerva matematikore”**, nënkupton vlerën aktuale të detyrimeve të ardhshme të Siguruesit, pasi janë zbritur vlera aktuale e detyrimeve të ardhshme të të Siguararit.
15. **“Person fizik”**, nënkupton individin me zotësi juridike dhe për të vepruar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Termt e papërcaktuar në këtë kontratë kanë kuptimin e dhënë në ligjin nr.52/2014, datë 22/04/2014, dhe në mungese të përcaktimit në ligj, kanë kuptimin e dhënë në fjalorin e gjuhës shqipe.

### **1.2 PRODUKTI I SIGURIMIT**

2. Kontraktuesi /i Siguruari i paguan Siguruesit primin dhe Siguruesi, nëse ndodh ngjarja e sigurimit i paguan Përfituesit shumën e siguruar ose një pjesë të saj sipas kontratës.
3. Sigurimi i jetës në rast vdekje apo mbijetesë mund të kryhet me ose pa kontroll mjekësor.

4. Përveç sigurimit të jetës në këtë kontratë mund të ofrohen edhe sigurime shtesë, sipas kushteve shtesë të Siguruesit.
5. Sipas këtyre kushteve të përgjithshme, kufiri minimal dhe maksimal i moshës së personave të sigurueshëm është 18-55 vjeç. Sigurimi përfundon kur i Siguruari arrin moshën 65 vjeç. Personat, të cilët në momentin e aplikimit kanë probleme shëndetësore, mund të sigurohen për rrezik jonormal, rrezik i cili vlerësohet rast pas rasti konform procedurës së vlerësimit së riskut të kryer nga Siguruesi ose për ta mund të refuzohet kërkesa e tyre për sigurim. Personat e paaftë për punë nuk mund të sigurohen.
6. Të gjitha njoftimet, deklaratimet dhe kërkesat e palëve kontraktuese duhet të paraqiten me shkrim dhe të respektojnë kushtet e përgjithshme të sigurimit.

### **1.3 KËRKESA PËR SIGURIM JETE**

2. Për lidhjen e kontratës së sigurimit të jetës, kontraktuesi/i siguruari duhet të paraqesë kërkesën për sigurim në adresë të Siguruesit. Kërkesa duhet të plotësohet tërësisht, me vërtetësi, saktësi dhe në të duhet të shënohen të gjitha faktet me rëndësi për marjen në sigurim dhe lidhjen e kontratës. Siguruesi ka të drejtë që, në rast se e gjykon të arsyeshme, t'i kërkojë të Siguarit të kryejë kontrollin mjekësor sipas udhëzimeve të tij.
3. Siguruesi ka të drejtë që, brenda një periudhe kohe minimumi 15 ditë nga dita e marjes në dorëzim të kërkesës për sigurim, të kryejë vlerësimin e riskut dhe të marrë një vendim për pranimin ose refuzimin e kërkesës për sigurim.

### **1.4 POLICA E SIGURIMIT DHE KARTA E SIGURIMIT**

2. Siguruesi lëshon Policën e Sigurimit si një dokument që vërteton lidhjen e kontratës së sigurimit. Bashkë me Policën e Sigurimit, Siguruesi lëshon për të Siguarin edhe Kartën Personale të Sigurimit.
3. Polica për sigurimin e Jetës përmban të dhënat e plota të siguruesit, si dhe emër, mbiemër, numrin e kartës së identitetit dhe adresën e të siguarit, datëlindjen, llojin e mbulimit, fillimin dhe përfundimin e periudhës së sigurimit, shumën e sigurimit, primin e sigurimit dhe datën e pagesës së tij, përfituesin në rast vdekjeje ose mbijetese dhe datën e lëshimit të policës. Karta e Sigurimit përmban një numër serial, numrin e policës së sigurimit, afatin e përfundimit të sigurimit, si dhe identitetin e personit të siguar të shoqëruar me fotografi.
4. Polica e Sigurimit do të përmbajë domosdoshmërisht edhe tabelën e vlerave të Primit të kthyeshëm, si dhe tabelën e Shumës së kapitalizuar.
5. Nesë bashkë me sigurimin e jetës është rënë dakord edhe për sigurime shtesë, pjesë përbërëse të kontratës së sigurimit do të jenë edhe kushtet shtesë të siguruesit për sigurimin shtesë përkatës.

### **1.5 PRIMI DHE SHUMA E SIGURIMIT**

2. Siguruesi përcakton primin e sigurimit vjetor bazuar në moshën, gjininë e të Siguarit, shumën e siguar, periudhën e sigurimit dhe kushtet e tjera të përcaktuara nga Siguruesi.
3. Palët bien dakord për përcaktimin e Shumës së Sigurimit në varësi të tarifave të Siguruesit, moshës së të Siguarit, gjendjes shëndetësore të të Siguarit, veprimtarisë profesionale, veprimtarisë së kohës së lirë dhe periudhës së sigurimit.

## **1.6 PËRFITIMET E PAGUESHME**

2. Siguruesi detyrohet të paguajë përfitimet e pagueshme të përcaktuara në Policën e Sigurimit në mbështetje të këtyre kushteve të përgjithshme në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit si mëposhtë vijon:
  - a. Në rast vdekje të personit të siguruar para përfundimit të periudhës së sigurimit
  - b. Në rast mbijetese të të Siguruarit deri në përfundimin e periudhës së sigurimit.
3. Në rastet e dëmshpërblimit për vdekjen si pasojë e një sëmundje, Siguruesi ka të drejtë të shqyrtojë të dhënat mjekësore e personale të të Siguruarit.

## **1.7 KAPITALIZIMI I SHUMËS SË SIGURIMIT**

1. Kontaktuesi/i Siguruarit mund të kërkojë kapitalizim të shumës së sigurimit pa pagesë të mëtejshme të primit me shumë sigurimi të zvogëluar (kapitalizuar). Kapitalizimi i shumës së sigurimit është i mundur gjatë gjithë periudhës së sigurimit vetëm dhe nëse është paguar primi i sigurimit për të paktën tre vitetet e para të sigurimit.
2. Siguruesi ka të drejtë t'i ofrojë Kontraktuesit/të Siguruarit vlerën e primit të Kthyeshëm vetëm pas përfundimit të vitit të tretë të sigurimit sipas tabelës përkatëse, nëse gjatë periudhës së sigurimit ka rrethana që vështirësojnë pagesën e detyrimeve nga njëra prej palëve, me kusht që për atë periudhë sigurimi të jenë paguar primet e sigurimit. Në këtë rast detyrimet e Siguruesit përfundojnë në orën 00.00 të ditës kur paguhet vlera e primit të kthyeshëm dhe dorëzohet polica e sigurimit.

## **1.8 PËRJASHTIME DHE KUFIZIME TË DETYRIMEVE TË SIGURUESIT**

### **Detyrimet e siguruesit, primi i kthyeshëm**

Siguruesi nuk është i detyruar të paguajë të gjithë vlerën e shumës së siguruar të rënë dakord, por vetëm vlerën e primit të kthyeshëm, konform Tabelës së Primit të Kthyeshëm të përcaktuar në Policën e sigurimit, në rastet e mëposhtme:

1. Nëse i Siguruarit kryen vetëvrasje gjatë dy viteve të para të sigurimit, ose vdes si pasojë e një përpjekje për vetëvrasje dhe kjo ngjarje me pasojë vdekjen kryhet gjatë dy viteve të para të sigurimit.
2. Nëse Përfituesi, apo një trashëgimtar, shkakton me qëllim vdekjen e të Siguruarit dhe të paktën 3 prime vjetore janë paguar deri në kohën e vdekjes;
3. Nëse vdekja e të Siguruarit vjen si pasojë e veprimeve luftarake, rebelimeve, grevave, trazirave qytetare, terrorizmi, apo përleshje të armatosura;
4. Nëse vdekja e të Siguruarit vjen si pasojë e dënimit me vdekje, ose nëse i Siguruarit vdes teksa në mënyrë të vetëdijshme po përgatit, kryen apo provon të largohet nga vendngjarja pas kryerjes së një veprimi kriminal;
5. Nëse vdekja e të Siguruarit është pasojë e një tërmeti, katastrofe natyrore apo çdo fenomen natyror i këtij klasifikimi;
6. Nëse vdekja e të Siguruarit vjen si pasojë e pjesëmarrjes në gara me mjete motorike në tokë apo në ajër si dhe me mjete sportive profesionale.
7. Nëse të dhënat e paraqitura në pyetesorin mbi shëndetin e të Siguruarit nuk janë të sakta;
8. Nëse vdekja e të Siguruarit vjen si pasojë e AIDS (Acquired Immune Deficiency Syndrome) apo si pasojë e abuzimit me alkoolin, drogat apo lëndët e tjera narkotike;
9. Nëse Ngjarja e sigurimit ka ndodhur si pasojë e përpjekjes për të kryer, apo kryerjes së një aborti jo spontan dhe të pakëshilluar nga mjeku specialist.
10. Nëse Ngjarja e Sigurimit ka ndodhur si pasojë e shpërthimit apo rrezatimit bërthamor ose atomik;

11. Nëse vdekja e të Siguruarit ka ardhur si pasojë e sporteve të rrezikshme (alpinizimi, hedhja me parashutë etj);
12. Nëse vdekja e të Siguruarit ndodh si pasojë e qëndrimit në zona klimaterike ekstreme;
13. Nëse vdekja e të Siguruarit ndodh si pasojë e përdorimit të një avioni, përveçse në rastet e udhëtimit në avionë të licencuar për transportin e pasagjerëve.

## **1.9 NGJARJA E SIGURIMIT**

### **a. Njoftimi i ngjarjes së sigurimit**

1. Përfituesi ose i Siguruari detyrohet që me ndodhjen e rastit të sigurimit të njoftojnë me shkrim Siguruesin brenda 7 ditësh nga dita e ngjarjes.
2. Njoftimi bëhet me formularin përkatës të Siguruesit dhe bashkë me të paraqiten dokumentat e mëposhtme:
  - i. Originali i policës së sigurimit të jetës dhe të kartës personale të sigurimit;
  - ii. Kopje të dokumentit të identifikimit;
  - iii. Çertifikatën e vdekjes ose dokument tjetër që vërteton vdekjen e të Siguruarit;
  - iv. Raporti mjekësor për kohën, shkaqet e vdekjes, etj.;
  - v. Epikrizë mjekësore nga mjeku që e ka kuruar ose mjekuar të ndjerin;
  - vi. Dëshmi trashëgimie nëse si përfitues të policës janë përcaktuar trashëgimtarët e ligjshëm;
  - vii. Prova për lidhjen familjare nëse nuk janë përcaktuar përfitues;
3. Siguruesi ka të drejtë të kërkojë dhe prova të tjera të nevojshme për vërtetimin e të drejtës për pagesë.
4. Shpenzimet që kanë të bëjnë me njoftimin e ngjarjes së sigurimit janë në ngarkim të personit që bën njoftimin.

### **b. Pagesa e shumës e sigurimit**

1. Siguruesi paguan shumën e sigurimit në përputhje me kontratën brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita që ka marrë njoftimin e ngjarjes së sigurimit dhe dorëzimit të të gjithë dokumentave dhe provave të parashikuara në kreun “Ngjarja e Sigurimit”. Forma dhe mënyra e tërheqjes së shumës së siguruar nga i Siguruari/Përfituesi përcaktohen me marrëveshje të veçantë midis palëve.
2. Në rast se përfituesi nuk është përcaktuar nga kontraktuesi/i siguruari, siguruesi i paguan shumën e sigurimit personit që gëzon këtë të drejtë në bazë të dispozitave ligjore mbi trashëgiminë.

## **1.9 PËRCAKTIMI I PËRFITUESIT**

2. Kontraktuesi/i Siguruari përcakton në kontratë përfituesin e shumave të pagueshme që rrjedhin nga kontrata. Në të kundërt, zbatohen dispozitat e Kodit Civil mbi trashëgiminë.
3. Nëse Përfituesi është nën 18 vjec, atëherë shumën e sigurimit do t’i paguhet prindërve apo kujdestarëve ligjorë.
4. Përfituesi do të jetë i vetmi që do të marrë shumën e sigurimit, pavarësisht se kur apo si është përcaktuar si Përfitues dhe pavarësisht nëse ka të dhënë apo jo miratimin e tij para vdekjes së të Siguruarit, në mënyrë që të mund t’i drejtohet Siguruesit me një kërkesë për pagesën e shumës së sigurimit.

### **1.10 PAGESA E DETYRIME TË TJERA**

2. Përfituesi/I siguruari detyrohet të paguajë të gjitha detyrimet e parashikuara në legjislacionin tatimor në fuqi.

### **1.11 NDRYSHIMI I KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT**

Këto Kushte të Përgjithshme të Sigurimit mund të zëvendësohen apo të ndryshohen me miratimin e një aktuari, dhe pas vënies në dijeni të Autoritetit Mbikqyrjes Financiare, ndryshime për të cilat Kontraktuesi/i Siguruari duhet të njoftohet plotësisht e saktësisht në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **1.12 LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

2. Kjo kontratë hartohet në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, si Kodin Civil, ligjin nr.52/2014, datë 22.05.2014 “*Për sigurimin dhe risigurimin*”, në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar), si dhe rregulloret e brendshme të Shoqërisë sigurorese.
3. Për çdo rregullim të marrëdhënieve midis Siguruesit, të siguarit, kontraktuesit, përfituesit dhe personave të tjerë, për të cilët nuk shprehen këto kushte, janë të zbatueshme parashikimet e Kodit Civil.
4. Siguruesi në kuadër të kësaj kontrate mbledh, ruan depoziton dhe përdor të dhënat personale të nevojshme për nënshkrimin e polices së sigurimit, në respektim të dispozitave të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar), si dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij.

#### **SHEMBULL:**

Qëllimi i pasqyrimin të këtij shembulli është për t'i treguar të siguarit modelin e llogaritjes, por të dhënat (tarifat) në të janë të rastësishme dhe nuk ka lidhje me të dhënat (tarifat) e përcaktuara në kontratën që lidhet me të siguarin.

I siguruari (mashkull) - 30vjeç  
Kohëzgjatja e sigurimit -25 vjet  
Primi vjetor - 1000€  
Shuma e siguar - €

Në rast të vdekjes, primit të kthyer si dhe shumës së kapitalizuar i shtohet edhe fitimi i pritshëm.

Pas vitit	Primi i kthyer (€)	Përfitimi në rast vdekje (€)	Shuma e kapitalizuar (€)
0	0	25,073	0
1	0	25,073	0
2	0	25,073	0
3	1,622	25,073	2,094
4	2,521	25,073	3,218
5	3,432	25,073	4,331
6	4,356	25,073	5,434
7	5,292	25,073	6,527
8	6,241	25,073	7,609
9	7,203	25,073	8,681
10	8,179	25,073	9,744
11	9,168	25,073	10,796
12	10,172	25,073	11,839
13	11,190	25,073	12,874
14	12,225	25,073	13,902
15	13,277	25,073	14,925
16	14,347	25,073	15,941
17	15,436	25,073	16,953
18	16,546	25,073	17,962
19	17,679	25,073	18,970
20	18,837	25,073	19,977
21	20,020	25,073	20,986
22	21,233	25,073	21,998
23	22,477	25,073	23,015
24	23,756	25,073	24,039
25	25,073	25,073	25,073